

Mbështetje për pesë projekte

PRISHTINË, 5 SHTATOR —

Universiteti i Prishtinës (UP) mori sot mbështetje nga shteti austriak për pesë projekte në vlerë prej 833 mijë euro, projekte këto që vlerësohen se do të ofrojnë mbështetje përmbajtjesore për procesin refor-

mues në arsimin e lartë në Kosovë. Kjo u bë e ditur me rastin e lansimit të projektit ËUS– Austria, në të cilën pjesëmarrës ishin dekanët e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës dhe financuesit e projekteve. Bud Dedaj, koordinator i

programeve të ËUS-Austria për Kosovë, tha se pesë projektet e planifikuara për Universitetin e Prishtinës janë të projektuara për tri vitet e ardhshme dhe shprehin ndihmën që Austria është duke dhënë përmes Agjencisë austriake

të zhvillimit për arsimin e lartë në Kosovë. Në kuadër të këtyre pesë projekteve përfshihet: zhvillimi i tre master programeve të reja në Fakultetin Juridik, një në Fakultetin Filozofik dhe në një në Fakultetin e Mjekësisë.

